



Buletini

- * Hyrje
- * Aktivitetet e përgjithshme
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- * Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)

*

Maj 2020

Hyrje

Si rezultat i rrethanave të krijuara nga pandemia COVID 19 dhe masave të ndërmarra nga Qeveria e Republikës së Kosovës, Akademia e Drejtësisë ka vazhduar veprimtarinë e saj duke i ri dizajnuar aktivitetet trajnuese si në trajnimet e vazhdueshme ashtu edhe në ato fillestare në përputhje me kërkesat e platformës ZOOM.

Gjatë muajit maj përveç aspektit të trajnimeve edhe aktivitetet tjera me theks të veçantë takimet e ndryshme të stafit, takimet me trajnues apo edhe me bashkëpunëtorë të ndryshëm të Akademisë është vazhduar në mënyrë virtuale nga shtëpitë nëpërmes mjeteve dhe komunikimeve elektronike.

Për më tepër në këtë buletin në rubrikat në vijim pasqyrohen aktivitetet e përgjithshme në dobi të zbatimit të programeve trajnuese, aktivitetet e realizuara nga Programi i Trajnimeve të vazhdueshme të specifikuara sipas temës së trajnimit, kohëzgjatjes dhe përfituesve të saj, si dhe aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare sipas sesioneve dhe moduleve trajnuese.

Aktivitetet të përgjithshme

Bashkëpunimi me Projekte të Donatoreve

Në vazhden e bashkëpunimit me miqtë dhe partneret e AD-së janë realizuar takime virtuale për të konkretizuar aktivitetet e asistencës në zhvillim dhe zbatim të programeve trajnuese. Në funksion të kësaj është mbajtur takimi virtual me përfaqësuesit e OSBE-s, në lidhje me gatishmërinë e tyre për të ndihmuar dhe asistuar AD në zhvillimin dhe avancimin e kurikules trajnuese për shkrim ligjor të ndërlydhura me aktet akuzuese të prokuroreve. Gjate takimit është dakorduar që OSBE të angazhojë tre konsulent ndërkombëtarë që do të ndihmojnë në përgatitjen modulare të trajnimit, si dhe të modulit TT. Gjithashtu, tre trajnues nga AD (dy prokurore dhe një gjyqtarë) do të asistojnë konsulentë ndërkombëtar në realizimin e këtij projekti.

Në vijim është mbajtur takim virtual me përfaqësuesit e UNDP-se me ç'rast është diskutuar forma e bashkëpunimit në përkrahje të Departamentit Special në Gjykatën Themelore, si dhe mundësitë e bashkëpunimit në zhvillimin e kurikules trajnuese në fushën e diskriminimit.

AD ka vazhduar komunikimin me organizatën gjermane për zhvillim IRZ, ku është koordinuar organizimi i Webinarit mbi Bazat e së Drejtës dhe Politikës së Bashkimit European, ku ligjërues në këtë seminar do të jetë: Prof. Dr. Jan Bergmann, Kryesues i Senatit në Gjykatën e Lartë Administrative Baden-Württemberg.

Diskutimi dhe koordinimi i mëtutjeshëm me projektin e KE-së KOSEJ në hartimin dhe

zhvillimin e kurikules trajnuese për Menaxhim të Gjykatave dhe Prokurorive, është vazhduar edhe gjatë muajit maj, kryesisht nëpërmes komunikimit elektronik me qëllim të koordinimit sa më të mirë. KOSEJ është zotuar se do të ndihmojë AD me një softwer online i cili mundëson vlerësimin e nevojave për trajnime, fillimisht për indikatorët e CEPEJ-it e me pas edhe në nevojat për trajnime të tjera.

OPDAT ka rekomanduar që një pjesë e modulit për menaxhimin e prokurorive të marrë rol udhëheqës KOSEJ, përderisa përfaqësuesit e OPDAT-it do të ndihmojnë dhe asistojnë.

Përveç kësaj është vazhduar me procedimin e pyetësorit tek Departamentet e Krimeve të Renda, proces ky i mbështetur nga OPDAT i cili ka synim mbledhjen e informacionit nga udhëheqësit e departamenteve në lidhje me vlerësimin dhe analizimin e kapaciteteve të AD nëpërmes metodologjisë SWAT. Qëllimi i kësaj analize është të ndihmojë AD-në në identifikimin e nevojave, përmirësimin të metodologjisë së vlerësimit të nevojave për trajnim, si dhe vlerësimin e strukturës së programeve të trajnimit.

Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

Program i Specializuar Trajnimi -Shpërlarja e Parave- Sesioni I

Më 6 dhe 7 maj 2020, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, në platformën ZOOM ka realizuar trajnimin, me temë “Program i Specializuar Trajnimi - Shpërlarja e Parave- Sesioni I”.


Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive rreth bashkëpunimit ndërkombëtar në hetimin sa më suksesshëm, grumbullim e provave dhe çështjeve problematike të cilat shfaqen në praktikë me rastin e hetimit dhe gjykimin të pastrimit të parave dhe veprave penale që ndërlidhen me të.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtua pastrimi i parave ndër të cilat u potencua se përbënë procesin për të fshehur burimin e parave që rrjedhin nga veprimtaria kriminale. Më tej u tha që përgjithësisht përfshin shndërrimin e të ardhurave të krimit në një formë të ligjshme, duke përfshirë mbledhjen, përpunimin dhe ana-


lizimin e të dhënave financiare me qëllim që ato të dhëna financiare të kualifikohen si prova. Vëmendje iu kushtua paraprakisht hetimit të skemave në shkallë të gjerë të pastrimit të parave, krimeve tatimore dhe doganore duke përfshirë bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar që në praktikë është më se i nevojshëm për t'i hetuar dhe gjykuar këto vepra penale të cilat përbëjnë rrezik për zhvillimin ekonomik të një vendi.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në diskutime interaktive të pjesëmarrësve të trajnimit dhe të trajnuesve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë nga Gjykata e Apelit, gjyqtar dhe prokurorë të nivelit themelor nga regjione të ndryshme të Kosovës.



Shqyrtimi kryesor dhe mjetet provuese



Më 13-14 maj 2020, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshëm, në bashkëpunim me projektin e BE-së BE “Mbështetje Kodit Civil Faza 2”, organizoj trajnimin me temë: “Shqyrtimi kryesor dhe mjetet provuese”.

Në pamundësi të realizimit të trajnimit klasik, ky trajnim u mbajt virtualisht përmes platformës elektronike Zoom Pro. Trajnimi u zhvillua direkt/live për dy ditë, dita I me 13.05.2020 nga ora 13:00-15:30 dhe dita II me 15.05.2020 nga ora 13:00-15:30.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me tematikën e shqyrtimit kryesor dhe mjeteve provuese.

Në dy ditët e trajnimit u trajtuan temat në vijim: Konvokimi dhe mbajtja e shqyrtimit kryesor; Mjetet provuese dhe marrja e provave; Llojet e mjeteve provuese në procedurën kontestimore; dhe Barra e të provuarit në procedurën kontestimore dhe sigurimi i provës.

Në trajnim u potencua se shqyrtimin kryesor

është etapa më e rëndësishme e procedurës kontestimore, qendër e ndodhive më të rëndësishme procedurale sepse në aspektin e procedurës provuese në shqyrtimin kryesor verifikohen pretendimet dhe tezat e palëve dhe vërtetohet materiali procedural në baë të të cilit hartohet aktgjykimi. LPK përcakton obligimet e palëve ndërgjyqëse që të provojnë faktet mbi të cilat i bazojnë kërkesat dhe pretendimet e veta. Në të provuarit përfshihen të gjitha faktet që janë të rëndësishme për dhënien e vendimit, ndërsa gjykata vendos se cilat prova do të merren me qëllim të vërtetimit të fakteve vendimtare.

Në trajnim u veçua mendimi se me LPK në fuqi përcaktohet radha e ndërmarrjes së veprimeve procedurale, duke përfshirë edhe radhën e marrjes së provave, pastaj përcaktohet procedura e marrjes në pyetje të dëshmitarëve, të ekspertëve dhe palëve. Gjithashtu në trajnim u zbërthye procedura e cila zhvillohet në shqyrtimin kryesor lidhur me mënyrën e të provuarit sepse në praktikën gjyqësore janë paraqitur vështirësi në procedurën e të provuarit.

Në trajnim ishte me dobi të posaçme edhe trajtimi i çështjeve me element civil që janë trajtuar në Gjykatën Kushtetuese, apo ato që preokupojnë gjyqtarët në Republikën e Kosovës, kur dihet fakti se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë përfundimtare dhe të zbatueshme pa mundësi apelimi. Këtu fokusi ishte në standardet që zbaton Gjykata Kushtetuese e Kosovës në çështjet që kanë të bëjnë me shqyrtimin kryesor, parimet kryesore procedurale dhe kategoritë tjera procedurale duke u shoqëruar edhe me interpretimet që ka bërë GJEDNJ në Strasburg lidhur me këtë tematikë. Veçmas u shtjelluan kërkesat dhe garancionet që përmban Kushtetuta e Kosovës dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me parimin e gjykimit të drejtë dhe zbatimi i tyre në praktikën e gjyqësorit të rregullt dhe atë të Gjykatës Kushtetuese në çështjet me

elemente civile në Republikën e Kosovës.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore, ku secili nga pjesëmarrësit pati mundësin të jetë aktiv gjatë gjithë kohës së trajnimit.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: Gjyqtarë nga Gjykata e Apelit, si dhe gjyqtarë e prokurorë të nivelit themelore nga regjione të ndryshme të Kosovës.

Ndërmjetësimi, në aspektin Civil, Penal dhe Ekonomik

Më 20-21maj 2020, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, në bashkëpunim me Programin e USAID – Drejtësia Komerciale, implementuar nga CHECCHI and COMPANY, realizuan trajnimin, me temë “Ndërmjetësimi, në aspektin Civil, Penal dhe Ekonomik”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor me dispozitat e Ligjit për Ndërmjetësimin si dhe zbatimi i drejtë i tyre në praktikë e që rezulton drejtpërdrejtë në zvogëlimin e lëndëve në gjykata dhe prokurori.


Gjatë këtij trajnimi On-line në platformën Zoom u trajtua ndërmjetësimi si formë alternative e zgjidhjes së mosmarrveshjeve në mes të palëve, e cila sukseseshëm arrin që të rezistoj kohës, duke u cilësuar si një avantazh të cilin e ka ky proces, më tepër se sa zgjidhjet gjyqësore të rasteve. Trajnimi i kushtoj vëmendje problemeve të cilat hasen në praktikë

për gjyqtarët, prokurorët si dhe stafin e gjykatave dhe prokurorive për identifikimin më të lehtë të lëndëve të përshtatshme të cilat mund referohen për ndërmjetësim.

Përveq kësaj u diskutuan dhe u trajtuan parimet e ndërmjetësimit, inicimi i procedurës së ndërmjetësimit, ndërmjetësimi i detyrueshëm, procedura dhe obligimet e gjyqtarëve, zhvillimi i procedurës së ndërmjetësimit, marrëveshja e ndërmjetësimit dhe efektet e saj, të drejtat dhe detyrimet e palëve në procedurën e ndërmjetësimit.

Metodologjia e trajnimit është bazuar në diskutime interaktive të pjesëmarrësve të trajnimit dhe të trajnuesve.

Përfitues të këtij trajnimi ishin Gjyqtarë, prokurorë, bashkëpunëtor profesional dhe ndërmjetësues nga regjioni i Gjakovës dhe Prizrenit.



Procedura gjyqësore në rastet e kompensimit të dëmit dhe kriteret e vlerësimit

Më 26-27 maj 2020, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin në bashkëpunim me projektin e BE-së -“Mbështetje Kodit Civil Faza 2” me temë: “Procedura gjyqësore në rastet e kompensimit të dëmit dhe kriteret e vlerësimit” në kuadër të PTV-së.

Në pamundësi të realizimit të trajnimit klasik, ky trajnim u mbajt virtualisht përmes platformës elektronike Zoom Pro. Trajnimi u zhvillua direkt/live për dy ditë, dita I me 26.05.2020 nga ora 13:00-15:30 dhe dita II me 27.05.2020 nga ora 13:00-15:30.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me tematikën e procedurës gjyqësore në rastet e kompensimit të dëmit dhe kriteret e vlerësimit.

Në dy ditët e trajnimit u trajtuan temat në vijim: Subjektet e të drejtës së në rastet e shkaktimit të dëmit, Sigurimi nga auto përgjegjësia dhe Sigurimi i punëtorëve në punë, Polisa e sigurimit TPL dhe kufijtë e mbulesës, Kërkesa për kompensim të dëmit, Shpërblimi i dëmit material dhe jo-material nga polisa e sigurimit, Kriteret për vlerësimin e dëmit, E drejta në rentë dhe regresimi i dëmit.

Në trajnim u potencua se në praktikën gjyqësore numri më i madh i kontesteve për kompensimin e dëmit paraqiten nga sfera e dëmeve të shkaktuara në komunikacion dhe si rezultat i lëndimeve të shkaktuara në punë. Fokusi i trajnimit ishte në mënyrat e trajtimit të dëmit, kompensimin e dëmit, bazat e përgjegjësive dhe regresimi në rastet e sigurimeve, pastaj ndërmarrja e masave të nevojshme nga ana e punëdhënësit për sigurimin e kushteve të punës ndaj punëtorëve duke përfshirë edhe kriteret e vlerësimit të dëmit në këto

raste.

Në trajnim u ofrua praktika gjyqësore dhe standardet evropiane dhe ndërkombëtare në rastet e kompensimit të dëmit. Pastaj u elaboruan përvojat dhe praktikatat e mira të shteteve në rajon në rastet e kompensimit të dëmit duke zbërthyer edhe kriteret e vlerësimit të cilat përdoren në këto raste. Gjithashtu u potencua se praktika gjyqësore është relativisht e zhvilluar lidhur me këtë tematikë, mirëpo numri i madh rasteve nëpër gjykata e Kosovës, dinamika e rritjes së numrit të rasteve të paraqitura për kompensim ka ndikuar që të ketë dallime në praktikën gjyqësore sidomos sa i përket kriterëve për përcaktimin e lartësisë së dëmit posaçërisht atij jo material. Andaj diskutimi i të gjitha aspekteve të kompensimit të dëmit si burim material juridik i marrëdhënieve të detyrimeve në trajnim ishte në funksion të unifikimit të praktikës gjyqësore dhe rritjes së cilësisë.

Në trajnim ishte me dobi edhe trajtimi i çështjeve lidhur me tematikën e procedurës gjyqësore në rastet e kompensimit të dëmit dhe kriterëve të vlerësimit që janë trajtuar në Gjykatën Kushtetuese. Këtu fokusi ishte në standardet që zbaton Gjykata Kushtetuese e Kosovës në çështjet që kanë të bëjnë me procedurën gjyqësore në rastet e kompensimit të dëmit duke u shoqëruar edhe me interpretimet që ka bërë GJEDNJ në Strasburg lidhur me këtë tematikë dhe kriteret e vlerësimit në raport me drejtat e njeriut si dhe hartimi i vendimeve gjyqësore në një procedurë të drejtë konform nenit 31 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 6 të KEDNJ.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritore për rastet konkrete.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarë nga Gjykata e Apelit dhe Gjykatat Hgj Themelore nga të gjitha regjionet, si dhe stafi administrativ nga regjioni i Pejës.



Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror dhe në rastet e ndryshimit të statusit të tyre

Më 29-30 maj 2020, Akademia e Drejtësisë organizoj trajnimin në bashkëpunim me projektin e BE-së -“Mbështetje Kodit Civil Faza 2”, me temë: “Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror dhe në rastet e ndryshimit të statusit të tyre” në kuadër të PTV-së. Ky trajnim u mbajt virtualisht përmes platformës elektronike Zoom Pro. direkt/live për dy ditë, dita I me 29.05.2020 nga ora 13:00 -15:30 dhe dita II me 30.05.2020 nga ora 13:00 -15:30.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me tematikën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror në rastet e ndryshimit të statusit të tyre.

Në dy ditët e trajnimit u trajtuan temat në vijim: Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror; Adoptimi, Amësia dhe atësia; Mënyrat dhe metodat e komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurë gjyqësore; dhe Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në procedurën e kundërshtimit dhe vërtetimit të atësisë apo amësisë si dhe parimi i interesit më të lartë të fëmijës.

Në trajnim u zbërthyen çështjet rreth mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve pa kujdes prindëror, si dhe format e mbrojtjes së veçantë të këtyre fëmijëve të cilat janë të normuara me Ligjin për Familjen, duke pasur si reference Konventën për të Drejtat e Fëmijës. Gjithashtu u diskutua për mënyrën dhe metodat e komunikimit të gjykatës me fëmijët në procedurë gjyqësore, parimin e interesit më të lartë të fëmijës, rolin e gjykatës dhe organit të kujdestarisë në procedurat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve pa kujdes

prindëror dhe në rastet e ndryshimit të statusit të tyre.


Në trajnim u trajtua legjislacioni për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në vendin tonë dhe praktika gjyqësore u krahasua me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve posaçërisht me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve dhe rrjedhimisht u prezantuan praktikat më të mira për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve si në shtetet e rajonit ashtu edhe në praktikën e GJEDNJ.

Gjithashtu përmes analizës krahasuese u ofruan rekomandime veçmas për rolin aktiv që duhet të ketë gjykata në rastet kur pjesë e procedurave janë të miturit. Pikësynimi ishte përpjekja që gjyqtarët dhe kuadri tjetër i cili përfshihet në procedurat ku shtrohet nevoja e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve të jenë në gjendje që më kompetencë profesionale e duke zbatuar standardet më të larta vendore e ndërkombëtare fëmijëve tu ofrojnë mbrojtjen e të drejtave sipas parimit të interesit më të mirë për të miturit i cili parim duhet të jetë pikësynim mbizotërues në çdo rast dhe procedurë.

Fokusi ishte edhe në standardet që zbaton Gjykata Kushtetuese e Kosovës në çështjet që kanë të bëjnë me këtë tematikë duke u shoqëruar edhe me interpretimet që ka bërë GJEDNJ në Strasburg në raport me drejtat e njeriut si dhe hartimi i vendimeve gjyqësore në një procedurë të drejtë konform nenit 31 dhe 53 të Kushtetutës së Kosovës dhe nenit 6 dhe 8 të KEDNJ.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metoda të kombinuara të shpjegimit, duke përfshirë shpjegime teorike dhe praktike, të përcjella me shembuj nga praktika gjyqësore dhe diskutime për mënyrën e vendosjes meritorë për rastet konkrete.


Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore (divizioni civil) dhe zyrtar ligjor.



Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve Fillestare

Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar

Gjatë muajit maj, trajnimi teorik është realizuar në formë virtuale përmes platformës online ZOOM.



Sipas plan programit janë realizuar sesione trajnuese nga modulet përkatëse.

Në kuadër të trajnimit teorik për prokurorët e sapo emëruar janë realizuar (10) sesione trajnuese nga moduli: Shkathtësitë personale dhe ndërdisiplinare dhe Rendi juridik kombëtar dhe ndërkombëtar.

Nga nën moduli: “Menaxhimi i rasteve” për prokurorët e sapo emëruar janë realizuar tre (3) sesione trajnuese ndër të cilat janë trajtuar: Menaxhimi dhe karakteristikat e menaxhimit, planifikimi si funksion kryesor i menaxhimit, dëshmitë burimet dhe mbledhja e tyre si dhe dosje hetimore, mirëmbajtja e lëndëve në dosje dhe përpilimi i dosjeve përmes formës elektronike “Smil”.

Në kuadër të nën modulit: “Etika profesionale” janë realizuar gjashtë (6) sesione trajnuese ku prokurorët e sapo emëruar patën mundësi të përfitojnë njohuri të reja lidhur me Kodin e sjelljes dhe etikës dhe rëndësinë në zbatimin e tij në sistemin e drejtësisë, paanshmërinë – përmbajtjen dhe vlerat juridike të këtij parimi.

Më tej u trajtua, ndalimi i keqpërdorimit të fshehtësisë së informatave, kontaktet shoqërore me avokatë, pjesëtarë të familjes dhe persona të afërm dhe domosdoshmëria e veprimit urgjent në përjashtim ose heqje dorë nga shqyrtimi i çështjes - njoftimi i palëve me faktet dhe parimet e përgjithshme të etikës dhe sjelljes profesionale për prokurorë dhe gjyqtarë porotë, pavarësia dhe paanshmëria në profesion, veprimtaritë – përgjegjësitë prokuroriale dhe jo prokuroriale. Gjithashtu vëmendje të veçantë i'u kushtua edhe, arsimimit dhe trajnimet e prokurorëve – detyrë dhe parim specifik i etikës si dhe mbrojtja e të dyshuarve, të dëmtuarve dhe dëshmitarëve – parim specifik i etikës prokuroriale.

Po ashtu një (1) sesion trajnues është realizuar nga nën moduli: “E drejta e BE-së” me ç ‘rast pjesëmarrësit avancuan njohuri të reja rreth urdhër-arrestit evropian, mandati, funksioni dhe shqyrtimi gjyqësor në Bashkimin Evropian.

Me rastin e këtyre sesioneve trajnuese, prokurorët patën mundësi që të trajtojnë me hollësi elementet rreth temave të trajtuara duke parashtruar pyetje të shoqëruara me shembuj të ndryshëm të cilat i hasin gjatë praktikave profesionale.

Për këtë periudhë prokurorët e sapo emëruar nuk kanë realizuar trajnim praktikë në prokurori.

Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur 12 prokurorë të sapo emëruar gjenerata e (VIII).


Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar


Gjatë muajit maj gjyqtarët kanë vazhduar me realizimin e trajnimit teorik përmes platformës online “Zoom” sipas kalendarit trajnues. Në kuadër të trajnimit teorik për gjyqtarët e sapoemëruar janë realizuar (8) sesione trajnuese nga nën moduli: Kodi i Procedurës Penale.

Në kuadër të nën modulit “Dëshmitarët dhe të dëmtuarit në procedurën penale” janë realizuar tre (3) sesione trajnuese, ku gjyqtarët u informuan lidhur me: Dëshmitarët e mbrojtur dhe bashkëpunues, ndalimi i parashtrimit të pyetjeve që mund të zbulojnë identitetin, qasja e të dëmtuarit dhe mbrojtësit të viktimës në shkresat e lëndës, ndryshimi i aktgjykimit të formës së prerë lidhur me kërkesën pasurore juridike dhe masat për sigurimin e përkohshëm të kërkesës pasurore juridike të drejtuar kundër personave të tretë.

Nga nën moduli “I pandehuri në procedurën penale” janë realizuar pesë (5) sesione trajnuese, ku gjyqtarët e sapo emëruar patën mundësi të thellojnë njohuritë të reja në: I pandehuri si subjekt i procedurës penale, deklarimi i të pandehurit si provë, të drejtat dhe detyrimet e tij gjatë procedurës penale, pozita e të pandehurit pas ngritjes dhe gjatë procedurës së konfirmimit të aktakuzës, i pandehuri gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe e drejta për ushtrimin e mjeteve juridike dhe i pandehuri gjatë procedurës së shkurtër dhe procedura për ndihmë juridike ndërkombëtare.

Trajnimin fillestar e kanë ndjekur (37) gjyqtarë të sapoemëruar, shtatë (7) prej të cilëve janë të komunitetit serb.





Adresa “Lagjja e Spitalit”
Rr. Muharrem Fejza p.n
Prishtinë, Republika e Kosovës

Tel: + 383 38 200 18 660
E-mail: infoad@rks-gov.net
<https://ad.rks-gov.net>